



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br	201/23
Nr. i fq. / Br. st	- 3 -
Data: / Datum	15. 09. 2023
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, e VII-ta me radhë,
mbajtur më 6 korrik 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Perçuku, Alban Bajram, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Fakete Dushi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrovë (Nënkyrytar i Komunës), drejtoret e drejtive, si dhe Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjafsheshme për punë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 81/23 i datës 30.03.2023 për bartjen e të hyrave vetanake paraprake nga viti 2022 në vitin 2023.

Isuf Jashari, drejtore i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi në pikë të shkurta propozim – vendimin. Ndryshimi i këtij vendimit duhet të bëhet pas aprovimit të ligjit në nivelin qendror për bartjen e të hyrave vetanake. Ai propozoi që të përfshihen edhe tri projekte në këtë propozim – vendim:

- “Ndërtimi i urës mbi lumin “Podranqa” Vushtrri, shuma financiare në vlerë 50,000.00 euro;
- “Renovimi i palestrës “Jeton Tërstena” (elektrika, trafo) – Vushtrri”, shuma financiare në vlerë 60,000.00 euro;
- “Rregullimi i oborrit të QKMF-së në Vushtrri, shuma financiare në vlerë 20,654.15 euro.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se ftesa e kuvendit për thirrje të mbledhjes është bërë pa rekomandim të KPF-së, prandaj nuk është dashur të dërgohet. Lidhur me këtë, kryesuesja dhe kryetari është dashur t'i kenë parasysh këto çështje procedurale, ku ftesa për KPF dhe për

kuvend është dërguar në të njëjtën ditë. Prandaj, kur ftesa është dërguar të njëjtën ditë, pse është thirr KPF-ja? Prandaj, këtu kemi shkelje procedurale dhe nuk është dashur të vihem i në lajthitje.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ai tha se te <shpenzimet kapitale> është një vlerë e lartë, e cila prapë po bartet në këtë kategori. Është dashur të mendohet që mjetet e bartura të destinohen në kode buxhetore ku ka shpresë që të shpenzohen. E dimë se shpenzimi i mjeteve në investime kapitale aktualisht janë në nivelin e ultë dhe si të tilla, edhe pse janë të hyra vetanake do të pasqyrojnë bilanc negativ në fundvit dhe se kam frikën se të njëjtat prapë do të barten për vitin e ardhshëm.

Nuk e di a është diskutuar nga qeveria komunale dhe drejtoritë gjegjëse se ku kanë mundur këto mjete financiare të destinohen, në cilin kod buxhetor kishin mundur të aktivizohen dhe të hyjnë në funksion. Mendoj se fondi për bashkëfinancim, ndoshta do të ishte më i përshtatshmi që një pjesë e mjeteve të shkojnë aty. Sidoqoftë, kjo do të mbetet në përgjegjësinë e qeverisë komunale.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – sa i përket shqetësimit që e ngriti Ilmiu, e dimë që Ligji për Vetëqeverisjen Lokale i trajton mirë këto çështje, sepse seanca e kuvendit ka mundur të thirret edhe pa KPF. Mirëpo, në shenjë të respektit si organ e kemi thirr KPF-në që ta trajtojmë së bashku me juve. Ju mund t'i shikoni edhe praktikat e komuna tjera, psh. Komuna e Prizrenit, gjithmonë mbledhjet e KPF-së i mbanë vetëm një ditë para mbledhjes së kuvendit.

Propozim – vendimi nuk është që nuk mund të ndryshohet. Ky propozim mund të ndryshohet edhe gjatë mbledhjes së KPF-së, por edhe në kuvend. Pra, rekomandimet që i jep KPF-ja mund të jenë pjesë e propozimit. Pavarësisht që ka ardhur materiali, gjatë ditëve dhe gjatë punëve është vërejtur psh. ura që është dashur ta heqim për shkak të vërvimeve nuk ka qenë propozim i yni, por ka ardhur propozim nga drejtoria që është nevojë urgjente që duhet të jetë pjesë e këtij buxheti dhe e kemi trajtuar. Çështja tjetër është se një trafo duhet të vendoset në palestrën sportive, sepse në momenti që kemi dashur ta kyçim në rrjet palestrën sportive, pas vendosjes së ngrohjes, KEDS-si na ka detyruar që ta vendosim një trafo, sepse nuk jep pëlqim për kycje për shkak të rritjes së kapacitetit të shfrytëzimit të energjisë elektrike. Çështje tjetër që është e rëndësishme te bashkëfinancimi duhet të ceket se është rruga Pestovë – Druar, ku ministria i ka ndarë 100 mijë euro për rregullimin e kësaj rruge dhe besoj se do të kryhet brenda vitiit dhe një pjesë e madhe e kësaj shume do të transferohet aty. Pjesa tjetër janë shtëpitë që po ndërtohen me organizatën e Halil Kastratit janë të fondi për bashkëfinancim. Pastaj, projekti me “Islamic Relief”, serrat, tregu janë në përfundim dhe shumë shpejtë do të nënshkruhet edhe kontrata. Ndërkaq, rregullimi i lumbit “Silnica” është një projekt që veç është duke dalë në procedurë të prokurimit, ku nevojiten mjete financiare për mbushjen e fondit dhe besoj që do të shpenzohen. Sa i përket vërvimeve, 146 mijë euro që janë tek fondi për subvencione dhe transfere do të transferohen në fondin për subvencione, të cilat po tentojnë me i mbulu një pjesë të dëmeve që janë shkaktuar nga vërvimet. Pavarësisht asaj, 832 mijë euro ndoshta janë shumë për investime kapitale, por me vendos te fondi për subvencione, një gjë të tillë nuk e ka lejuar ministria, sepse është dashur një kategorizim se ku t'i derdhim mjetet. Prandaj, ky ka qenë qëllimi që e kemi thirr KPF-në, duke e respektuar si organ i kuvendit. Se pse i kemi dërguar dy ftesat përnjëherë, ka qenë që ta respektojmë afatin ligjor për kuvend. E kemi diskutuar me kryesuesen dhe kemi dashur që ta thirrim seancë urgjente brenda ditës, apo të nesërmen, ngase është kërkuar nga Ministria e Financave që sapo të votohen në kuvend, mjetet do të lirohen. Por, nuk e kemi parë të arsyeshme një gjë të tillë dhe e thirrëm KPF-në dhe seancën e jashtëzakonshme të kuvendit. Prandaj, konsideroj që këtu nuk ka shkelje ligjore, por thirrja

është sipas procedurës ligjore. E keni të drejtën që të bëni ankesë në MAPL, qysh keni bërë përpara dhe ata e shqyrtojnë ankesën.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – theksoi se ajo që e tha nënkyretari nuk qëndron, sepse në bazë të ligjit, çdo dokument (sidomos dokumentet financiare) duhet të shqyrtohet dhe të kalojë përmes KPF-së para se me shku në kuvend. Prandaj, në mënyrë kolegiale po ju bëj ftesë ta respektoni ligjin, pa pasur pretendime për të bërë ankesë dhe jemi për t'ju përkrahur, por mos të krijohen praktika të tilla.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyretar i komunës – tha se askush s'po tenton me vu askënd në lajthitje. Por, prapë po them që të drejtën e ankesës e ka secili anëtarë i kuvendit nëse mendoni se ka shkelje ligjore në thirrjen e mbledhjes. Prandaj, është mirë që ekziston një organ mbi kuvendin, sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se nuk është praktikë e mirë, sepse fillimisht na ka ardhur ftesa për kuvend, pastaj për KPF. Nëse ka qenë në pyetje afati kohor, ju mirëkuptoj dhe nuk jam kundër që t'ju jepet mundësia dhe koha.

Tek pika 7 – bujqësia (47024), në projektet: <Rregullimi dhe pastrimi i lumbit Llap – Silnica kodi (52290), shuma prej 305,368.00€>, ndoshta është projekt i vitit paraprak, por nëse mundemi me ndërhy në emërtim, nuk e kisha kufizuar vetëm tek lumi “Llap” dhe “Silnica”. Por, nëse ka mundësi ligjore, me i përfshi edhe lumenjtë dhe përrrockat tjera në mënyrë që të përdoret ky buxhet nëse mjafton.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyretar i komunës – sqaroi se ky projekt është i votuar në kuvend vitin e kaluar dhe është në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës. Prandaj, duhet ta mbulojmë me shpenzimet tona në mënyrë që të fillojnë procedurat e prokurimit, në mënyrë që t'i shpenzojmë edhe mjetet e ministrisë. Lumenjtë dhe përrrockat tjera janë në procedurë të prokurimit, në vlerë prej 600 mijë euro, si dhe mjetet nga fondi emergjent.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën **11:30**.

Bujar Klinaku

B. Klinaku

Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

M. Basholli

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

